

Titulli i projektit: **“Connecting Dots”**: Hulumtimi i trashëgimisë së përbashkët të filmit

Zbatuar nga: **DokuFest dhe Beldocs**

Mbështetur nga: Projekti “Kultura dhe Kreativiteti për Ballkanin Perëndimor” (CC4WBs)

Termet e Referencës (ToR) për Hulumtuesit

HISTORIATI

Rreth programit

Projekti "Kultura dhe Kreativiteti për Ballkanin Perëndimor" (CC4WBs), i financuar nga Bashkimi Evropian, është i fokusuar në nxitjen e dialogut në Ballkanin Perëndimor përmes mbështetjes të sektorëve kulturorë dhe krijues me qëllim të rritjes së sektorit socio-ekonomik. Gjatë një periudhe 48-mujore, projekti CC4WBs synon të përmirësojë performancën e sektorëve kulturorë dhe krijues me qëllim të rritjes së aftësive, njohurive dhe qasjes në ndihmën financiare me qëllim të rritjes së konkurrencës dhe për të mbështetur bashkëprodhimin dhe qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve në Ballkanin Perëndimor.

Historiati i projektit

DokuFest dhe Beldocs po fillojnë një partneritet strategjik për të bërë një analizë gjithëpërfshirëse të trashëgimisë së filmit jugosllav. Kjo nismë synon të dokumentojë zhvillimin historik të kinemasë në vendet e dala nga ish-Jugosllavia.

Objektivi i projektit

Projekti synon të mbështesë grupe të ndryshme në Kosovë dhe Serbi, duke përfshirë studiues-artistë, kineast, pjesëmarrës të festivalit, studentë universitarë, artistë, studiues dhe akademikë. Projekti synon ta arrijë këtë përmes një programi që lejon studiuesit-artistë të eksplorojnë historinë e filmit dhe edukimin shëndetësor, duke rezultuar në vepra të ndryshme artistike. Këto vepra do të ekspozohen në festivale, duke zgjeruar audiencën tek studentët e universitetit, artistët dhe akademikët, dhe kështu duke e promovuar edhe bashkëpunimin ndërdisiplinor. Projekti gjithashtu pasuron arkivat e filmit, duke ruajtur trashëgiminë kulturore të kinemasë së Kosovës dhe nxit shkëmbimin kuptimplotë mes profesionistëve, duke forcuar industrinë e filmit,



akademinë dhe artet. Në përgjithësi, projekti krijon një bazë për përfitime afatgjata, duke promovuar kërkimin, krijimin artistik, përhapjen e njohurive dhe ruajtjen/mbrojtjen kulturore në rajon.

Qëllimi i projektit

Studiuesit do të hulumtojnë në mënyrë të detajuar trashëgiminë e filmit jugosllav, duke u angazhuar në aktivitete të ndryshme të planifikuara për të zbuluar, dokumentuar dhe analizuar evolucionin historik të kinemasë në rajon.

Fushëveprimi dhe Aktivitetet

1. Programi Hulumtues:

Angazhimi në programin hulumtues për një periudhë 2-4 javore, midis janarit dhe shkurtit 2024, organizuar nga DokuFest dhe Beldocs, me vendndodhje në Prizren dhe Beograd për të hulumtuar në mënyrë gjithëpërfshirëse arkivat lokale të filmit dhe për të ndërvepruar me komunitetet e fushës së kinematografisë.

2. Paraqitja e Rezultateve Hulumtuese:

Paraqet një shumëllojshmëri të rezultateve hulumtuese, duke përfshirë postime (*blog posts*) dhe një punim kërkimor, duke përmbledhur gjetjet e programit.

3. Hulumtimi dhe analiza arkivore:

Kryen hulumtime të arkivave në institucionet e caktuara për të zbuluar historinë e kinemasë jugosllave dhe për të analizuar veprat kryesore dokumentare.

4. Ekspozimi dhe Prezantimi në Festivale:

Prezanton rezultatet artistike të programit në festivalet DokuFest dhe Beldocs, duke shfaqur gjithashtu zhvillimet në botime të ndryshme.

5. Përgjegjësitë:

- Angazhimi në aktivitete gjithëpërfshirëse hulumtuese duke përdorur materiale arkivore, gazeta dhe literaturë.
- Kryerja e analizave ndërdisiplinore duke kombinuar studimet kulturore, antropologjinë dhe historinë.
- Paraqitja e rezultateve të tilla si punime kërkimore, postime (*blog posts*), ekspozita dhe dokumentarë.
- Pjesëmarrja në programe vendore, duke ndërvepruar me komunitetet lokale dhe ata nga fusha e kinematografisë.
- Vendosja në fokus aspektet e ndjeshme gjinore dhe përfaqësimin e grupeve të cenueshme në filmat jugosllavë.



Kohëzgjatja e angazhimit: 4 muaj

Kualifikimet:

- Diplomë **pasuniversitare** në fushën e Studimeve Filmike, Histori, Studime Kulturore ose të ndonjë fushe të ngjashme.
- Përvojë e dëshmuar në kërkime me fokus në studimet e filmit.
- Aftësi të forta analitike, në të shkruar dhe komunikuese.
- Njohuri për kontekstin kulturor dhe historik të industrisë së filmit jugosllav.
- Aftësi për punë të pavarur dhe bashkëpunuese.

Procesi i aplikimit:

Kandidatët duhet të dorëzojnë një CV, letër motivuese dhe dy mostra të punës së mëparshme kërkimore.

Afati i fundit për aplikim: 20 dhjetor 2023

Vlerësimi:

Aplikimet do të vlerësohen bazuar në kualifikimet dhe potencialin për të kontribuar në qëllimet e projektit.

Të dhënat për kontakt dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Kosovë: Eroll Bilibani, Udhëheqës i DokuLab - DokuFest, erollb@dokufest.com

Serbi: Marko Grba Singh, Drejtor Artistik - Beldocs, marko.grba@beldocs.rs

